Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno: 09.08.2017
Nr.i Organit / Org.broj: 02 | Numri/Broj: 016/793 | Shtojcë / Prilog | Vlera / Vrednost

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008 dhe nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04. 2011, dhe Kontratës të lidhur në mes të Komunës së Vitisë – Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe OJQ Këshilli i Veprimit Rinor Lokal nr CA 09/2015 Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 330,00€ KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL NË VITI

### I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **330,00€** me shkronja ( treqindetridhjet euro), Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Viti, në emër të ndihmës financiare për zhvillimin e aktiviteteve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal.

### II

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga fondi burimor 21, kodi per subvencione dhe transfere i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë.
Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi transferohen në llogari të KVRL nga Vitia.
Obligohet kryetari i KVRL që të paraqes raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi të Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

### III

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

### IV

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Vendimi u dorëzohet:

1. K.V.R.L.- Viti
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi